

# BOTËKUPTIMI

Botëkuptimi dhe vlerat e Lëvizjes Bashkë i përkasin **të majtës demokratike**, e cila deri më sot ka pasur një pozitë marginale në vendin tonë.

Ne, aktivistët e Lëvizjes Bashkë, besojmë te dinjiteti njerëzor, i shprehur përmes lirisë dhe të drejtave individuale e kolektive. Ne luftojmë për **një shoqëri ku askush të mos ndihet i veçuar dhe i nëpërkëmbur**. Ne jemi kundër poshtërimit të njeriut nga njeriu dhe kundër çdo institucioni shtypës.

Ne mendojmë se pabarazitë e theksuara ekonomike prodhojnë shtypje e shfrytëzim, varfëri e varësi, pabarazi politike e deficit demokratik, degradim kulturor dhe mungesë emancipimi shoqëror. Ndaj luftojmë **për reduktimin e pabarazive ekonomike**, pjesëmarrje sa më të gjerë në jetën ekonomike dhe shtrirje të gjithanshme të begatisë.

**Ne besojmë fort te solidariteti i njeriut me njeriun** në punë, shkollë, vendbanim dhe gjerësisht në shoqëri. Pa solidaritet nuk ka shoqëri, por një luftë të të gjithëve kundër të gjithëve, ku në fund mbisundojnë ujtit. Solidariteti është fuqia kolektive e të pafuqishmëve individualisht dhe ngjizësi i shpresës për një kohë të re.

Ne mendojmë se puna është veprimtaria kryesore shoqërore, në të cilën shumica prej nesh kalon një pjesë të madhe të kohës së vetëdijshme. Si e tillë, ajo duhet të jetë në qendër të përpjekjes për të drejta, dinjitet dhe pjesëmarrje. Ne besojmë se njerëzimi ka potencialin e **ndërtimit të një shoqërie ku puna nuk shfrytëzohet dhe tëhuajësohet**, por është ushtrim i lirë i potencialeve krijuese të njeriut.

Ne u njohim punëtoreve e punëtorëve, të duarve e të mendjes, rolin kryesor në transformimin e shoqërisë sipas idealeve më emancipuese. Ato e ata, të varfër e shtresë e mesme, shumicë e heshtur publikisht, e dërrmuar ekonomikisht dhe dërrmuese numerikisht, kanë potencialin për të demokratizuar shtetin dhe mëkëmbur krejt shoqërinë.

Ne besojmë te **barazia gjinore** dhe luftojmë kundër çdo akti dhune, kërcënimi, nënçmimi e poshtërimi të gruas në shtet, shoqëri e familje.

Ne besojmë se **çdo njeri, pavarësisht kategorizimit**, orientimit dhe vetëpërkufizimit identitar – etnik, gjuhësor, fetar, seksual, krahinor etj. – **duhet të trajtohet me respekt e barazisht**, si dhe të mos diskriminohet as nga shteti, as nga shoqëria.

Ne vlerësojmë se demokracia është sistemi më i arrirë i organizimit politik të shoqërisë. Ndaj luftojmë që ajo të mos mbetet në letër, por të thellohet e të shtrihet në pjesën më të madhe të marrëdhënieve shoqërore. **Ne besojmë te një demokraci sa më pjesëmarrëse**, ku qytetarëve u garantohet jo vetëm vota e lirë dhe e baraspeshuar në zgjedhjen e përfaqësuesve, por edhe mundësia për ta ushtruar drejtpërdrejt pushtetin përmes **referendumeve**. Ne mendojmë se demokracia duhet të shtrihet edhe në **administrimin e vendit të punës** dhe në **organizimin e jetës në komunitet**.

Ne gjykojmë se **shteti social** është një nga arritjet më të mëdha të historisë. **Shëndetësia, arsimi, strehimi, integrimi social dhe mbështetja ekonomike** janë shtyllat e një shoqërie me rendin e duhur, si dhe kontribuuese në demokratizim.

Ne luftojmë **kundër degradimit mjedisor** dhe synojmë një model zhvillimi që u jep përparësi burimeve energjetike të rinovueshme dhe merr seriozisht në konsideratë të drejtën e njerëzve për një mjedis të pastër e të shëndetshëm.

Ne mendojmë se vendi i Shqipërisë është si e barabarta mes të barabartave në një Bashkim Evropian që bazohet në vlerat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe ndihmës reciproke.

Ne mendojmë se në të gjitha organizatat ndërkombëtare ku merr pjesë, Shqipëria duhet të japë kontributin e saj serioz në promovimin e paqes, demokracisë dhe mirëkuptimit.

Ne kërkojmë paqen në botë dhe besojmë **te solidariteti mes popujve**. Ne jemi kundër të gjitha formave të pushtimit, sundimit, grabitjes dhe këmbimit të pabarabartë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ne besojmë tek **e drejta e çdo populli për vetëvendosje**.

Ne, aktivistët e Lëvizjes Bashkë, **frymëzohemi nga lëvizjet shoqërore dhe figurat madhore të popullit shqiptar**, si dhe nga aspirata mbarëkombëtare për bashkim. Po ashtu motivohemi nga arritjet e mëdha të lëvizjeve shoqërore emancipuese nëpër botë, ku të shtypurit e të shfrytëzuarit kanë ngritur krye. Ne besojmë se **patriotizmi** i shëndoshë dhe **internacionalizmi** i vërtetë janë anët komplementare të përpjekjes për një mëmëdhe të begatë dhe botë në paqe e solidaritet.